



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 150/4 prot.

Tiranë, më 12. 2.2024

NJOFTIM
SHPLLJE PUBLIKE VENDIMI (JR) NR. 40, DATË 27.09.2023

Subjekti i rivlerësimit: **Edmond Shytko**

Në zbatim të neneve 133/a dhe 133/b të K. Pr. Civile, bëhet "Njoftim me shpallje publike" i vendimit (JR) nr. 40, datë 27.09.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko.

Ky njoftim së bashku me vendimin do të qëndrojë i afishuar për jo më pak se 20 ditë, në këndin e Njoftimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të botohet në rubrikën "Shpallje" në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹.

Shpallja është afishuar sot më datë 12 /02 /2024
(Emër, Mbiemër)
(Nënshkrimi)

(*Anisa Sjolimi*
Sjolimi)



¹ <http://kpa.al/shpallje>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 49 regjistër (JR)
Datë 22.11.2022

Nr. 40 i vendimit
Datë 27.09.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 27.09.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretare gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 49/2022 (JR), datë 22.11.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 566, datë 28.09.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5, të Kushtetutës, Neni F i Aneksit të Kushtetutës; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Neni 442 e vijues i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Edmond Shytka ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Edmond Shytka, ka dërguar në Komision një raport në të cilin, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar se: *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive; ka mosdeklarime ndër vite; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
 - 3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve në deklaratën për kontrollin e figurës dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.
 - 3.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr.



84/2016, pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Edmond Shytko bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 566, datë 28.09.2022.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 566, datë 28.09.2022, në bazë të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
6. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Edmond Shytko është marrë pas vlerësimit të të tri kriterëve, bazuar në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit:

i. Nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke kryer deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar parashikimit të nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016.

iii. Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji), me ankim kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
8. Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe ankimi me natyrë procedurale:

8.1. Procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk është kryer nga një “gjykatë e krijuar me ligj”, siç kërkohet nga neni 6/1 i KEDNj-së, për shkak të shkeljeve të legjislacionit të brendshëm për procedurën e emërimit të anëtarëve të Komisionit. Në lidhje me mënyrën e zgjedhjes së organit disiplinor dhe ekzistencën e garancive ndaj ndikimit të presioneve të jashtme, subjekti parashtron në ankim se anëtarët e Komisionit që shqyrtoan çështjen e tij nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes të përcaktuara në nenin C, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016.

8.2. Subjekti parashtron, gjithashtu, se sipas kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov v Ukrainës*, katër janë kriteret që duhet të merren në analizë për të përcaktuar nëse një organ që



vendos masat disiplinore ndaj gjyqtarëve është një organ i pavarur dhe i paanshëm. Në lidhje me kriterin e parë, përfaqësimin thelbësor të gjyqtarëve në organin disiplinor, rezulton se anëtarët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet specifik *ad hoc* parlamentar dhe asnjë anëtar nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e zgjedhjes.

8.3. Sipas subjektit të rivlerësimit ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, si dhe nenit 52, pika 1 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendon se në vendimin nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit, janë cenuar disa parime të procesit të rregullt ligjor si parimi i arsytimit të vendimit, parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i pavarësisë dhe paanësisë, parimi i ligjshmërisë, parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, parimi se ligji nuk ka efekt prapaveprues.

8.4. Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kërkesat e kësaj dispozite.

8.5. Subjekti i rivlerësimit parashtron se në seancën dëgjimore të datës 23.09.2022 konstatohen shkelje procedurale të kryera nga ana e trupit gjykues, si dhe nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar deri në marrjen e vendimit përfundimtar, për shkak të largimit nga seanca dëgjimore e këtij të fundit dhe zëvendësimit me një tjetër vëzhgues që nuk e njihnte çështjen e tij. Subjekti parashtron se është i paqartë se cili nga tri vëzhguesit ndërkombëtarë ka qenë prezent dhe ka dhënë mendimin në dhomën e këshillimit kur është diskutuar vendimarrja e Komisionit. Referuar parashikimeve ligjore për rolin e vëzhguesve të ONM-së roli dhe opinionet e tyre kanë qenë jo pak të rëndësishme në vendimarrjet e Komisionit.

9. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij parashtron si vijon.

9.1. *Për pasurinë apartament, me sip. 54,5 m², ndodhur në Pogradec, në vlerën 2.500.000 lekë, pasuri e fituar me dhurim*

9.1.1. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konkluzionin e Komisionit se kunati, M. Gj., nuk dispononte burime të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në Pogradec në shumën 2.500.000 lekë, parashtron se nga hetimi administrativ është provuar punësimi i tij në organizma ndërkombëtarë dhe në “{***}”. Sipas subjektit, kunati i tij ka pasur mundësi financiare për të justifikuar blerjen e apartamentit, dhe Komisioni ka pasaktësi për sa u përket llogaritjeve të të ardhurave të fituara prej tij në bazë të kontratave të punësimit të dorëzuara si provë nga subjekti.

9.1.2. Është i pabazuar konstatimi i Komisionit se duket e paqartë arsyeja e dhurimit të pasurisë së vetme të dhuruesit familjes së subjektit të rivlerësimit. Sipas subjektit, dhurimi nga kunati është bërë në shenjë mirënjohjeje për kujdesin që ka treguar subjekti dhe bashkëshortja për rritjen e tij, si dhe për ndihmën financiare për shkollimin e tij, si brenda dhe jashtë Shqipërisë.



9.2. *Për pasurinë apartament, me sipërfaqe 91,88 m², blerë në shumën 8.450.000 lekë, në vitin 2012, lidhur me burimin e deklaruar hua pa interes në shumën 15.000 euro, marrë vëllait dhe bashkëshortes së tij*

9.2.1. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se huadhënësit, vëllai dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të dhënë huan në shumën 15.000 euro për blerjen e apartamentit, pasi nga analiza financiare për periudhën 2005-2011 rezultoi bilanc negativ në shumën 21.182 euro. Komisioni, në kundërshtim me parashikimet ligjore, ka kryer një analizë financiare duke përfshirë të gjithë pasurinë e L. dhe M. Sh. dhe jo vetëm shumën prej 15.000 eurosh, të dhënë hua, objekt vlerësimi.

9.2.2. Nga Komisioni nuk është bërë një analizë financiare e plotë dhe e gjithanshme, duke përfshirë dhe shumën në euro që vëllai i subjektit dhe kunata kishin depozituar në BKT, dega Korçë, gjatë viteve 2010 e 2011, nga të cilat është bërë transfertë bankare, duke u tërhequr ligjërisht nga bashkëshortja J. Sh., shuma prej 15.000 eurosh. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë gjendjen e llogarisë bankare të L. Sh. e M. Sh. në BKT, dega Korçë, deri në vitin 2012, kur është marrë huaja nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe gjendjen bankare në Bankën Kombëtare të Greqisë.

9.2.3. Të ardhurat e vëllait dhe bashkëshortes janë përlogaritur nga Komisioni duke filluar nga viti 2005 dhe duke përjashtuar çdo lloj kursimi përpara këtij viti.

9.2.4. Shuma prej 3.000 eurosh, që vëllai ka dhënë si ndihmë për shkak të mbajtjes nga ana e subjektit të prindërve, është e ardhur nga tërheqja që L. Sh. ka bërë nga llogaria e tij në Bankën Kombëtare të Greqisë në vitin 2007.

9.2.5. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumën 16.859 euro, si kompensim dhënë nga shteti grek për familjen e L. e M. Sh.. Në këndvështrimin e subjektit të rivlerësimit konstatohet se shuma 16.859 euro, e marrë si kompensim nga vëllai e kunata, ka qenë e mjaftueshme dhe e justifikueshme për të dhënë huanë 15.000 euro.

9.2.6. Analiza financiare e Komisionit merr në konsideratë shpenzimet për jetesë, sipas EUROSTAT, për qytetarët evropianë, në këtë rast shtetasit grekë, ndërkohë që nuk mund të për afrohen shpenzimet e një qytetari grek me ato të një emigranti shqiptar.

9.3. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit për detyrimet financiare të tij dhe të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendon se provohet nga autorizimi i lëshuar se katër depozitimet e bëra nga bashkëshortja e tij J. Sh. në llogari të L. e M. Sh., në BKT, dega Korçë, në shumën e përgjithshme 10.100 euro, nuk kanë lidhje me shlyerjen e huasë prej 15.000 eurosh të marrë te vëllai dhe kunata për blerjen e apartamentit në Tiranë. Shuma prej 10.100 eurosh janë të ardhurat e vëllait dhe kunatës L. e M. Sh. të fituara në vite nga puna e tyre e kryer në Greqi, ku dhe janë emigrantë, të cilat mbaheshin *cash* prej tyre mbështetur dhe nga deklarata e lëshuar prej tyre. Duke mos qenë të ardhura familjare të subjektit ato dhe nuk janë deklaruar në deklaratimet vjetore periodike.*



IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Aspekte procedurale

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

10. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

11. Ankuesi Edmond Shytko, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit.
12. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15-ditor nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Edmond Shytko është shpallur në seancë publike më datë 28.09.2022. Vendimi i arsyetuar, nr. 566, datë 28.09.2022, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 26.10.2022, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 28.10.2022. Subjekti i rivlerësimit në datën 10.11.2022 ka përcjellë pranë Komisionit ankimin e tij kundër vendimit nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit, protokolluar me nr. {***} prot., datë 10.11.2022.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
14. Trupi gjykues shqyrtoi kërkesat e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet shtesë për marrjen e provave të reja, si dhe për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.



15. Trupi gjykues konstaton se bashkëlidhur ankimit subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj dhe këto akte të reja¹: (i) kërkesë e Edmond Shytkos drejtuar ILDKPKI-së, e datës 07.11.2022, në të cilën i kërkon mundësimin e deklaratave periodike të bashkëshortes së tij si person i lidhur me të për vitet 2019 e 2020; (ii) kopje të deklaratave periodike të vitit 2019 dhe të vitit 2020, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.
16. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj, në datën 10.08.2023, kërkesën për shqyrtimin e çështjes së tij në seancë gjyqësore publike dhe në datën 04.09.2023 parashtrimet shtesë, me të cilat ka kërkuar administrimin si prova të reja në seancë gjyqësore të akteve: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 14.06.2023, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, bashkëlidhur të cilës janë dërguar dy vërtetime për z. M. Gj.: vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për punësimin në subjektin {***}; si dhe vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për punësimin në subjektin privat “{***}”.
17. Trupi gjykues, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës së re të deklaratave periodike të dorëzuara në ILDKPKI për vitet 2019-2020, pasi u konsideruan si jorelevante në zgjidhjen e çështjes. Për sa i përket kërkesës për marrjen si prova të vërtetimeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, mbi punësimin e z. M. Gj. në {***} dhe në televizionin {***}, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, në kuadër të barrës së provës, ka pasur detyrimin të provojë të ardhurat nga punësimi i kumatit të tij që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe nuk ka pasur asnjë pengesë për të dorëzuar në Komision aktet në mbështetje të pretendimeve të tij.
18. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrollloi vendimin e Komisionit, zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke mos kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e akteve të reja në cilësinë e provës, në kuadër të kërimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe hetimit administrativ, trupi gjykues

¹ Shogëruar me aktet: (i) faturë e objekteve postare, datë 07.11.2022, e Edmond Shytkos, me ILDKPKI-në; (ii) dëftesë pranimit konfirmim marrje e objektit ekspres i brendshëm, datë 07.11.2022, me dërgues Edmond Shytko e marrës ILDKPKI-në; (iii) faturë e objekteve postare, datë 28.10.2022, e Edmond Shytkos, me Komisioni i Pavarur i Kualifikimit; (iv) lajmërim marrje me pranues lajmërimi Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.



vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i pretendimeve të subjektit mbi aspektet procedurale dhe procesin e rregullt

19. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk u krye nga një “gjykatë e krijuar me ligj”, siç kërkohet nga neni 6/1 i KEDNj-së, për shkak të shkeljeve të legjislacionit të brendshëm për procedurën e emërimit të anëtarëve të Komisionit. Në lidhje me mënyrën e zgjedhjes së organit disiplinor dhe ekzistencën e garancive ndaj ndikimit të presioneve të jashtme, subjekti parashtron në ankim se anëtarët e Komisionit që shqyrtuan çështjen e tij nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes të përcaktuara në nenin C, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa ligji nr. 84/2016 përcakton kriteret strikte për zgjedhjen e anëtarëve të organeve të rivlerësimit, nga ana tjetër nuk parashikon se si verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve nga Presidenti, Avokati i Popullit apo ONM. Ligji ka parashikuar afate shumë të shkurtra kohore për verifikim, të cilat praktikisht nuk i kanë lejuar organet e caktuara të bëjnë verifikimin e këtyre kushteve. Verifikimet e kushteve të zgjedhshmërisë janë kryer vetëm mbi bazën e vetëdeklarimit të kandidatëve. Avokati i Popullit ka kryer vetëm verifikimin nëse kandidatët kanë qenë ish-bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit dhe nuk ka kryer asnjë verifikim tjetër referuar të dhënave të paraqitura në dokumentacionin e tyre. Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet të ndryshojë praktikën e deritanishme dhe të marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit në lidhje me mospërmbushjen e kriterëve ligjore nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre. Referuar vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë* është Kolegji që duhet të vlerësojë përputhshmërinë e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në kuadër të nenit 6 të KEDNj-së.

19.1. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. 43/2022, në të cilin është shprehur se: “[...] Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t’i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën



me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj”.

20. Subjekti parashtroi se sipas kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov v Ukrainës*, katër janë kriteret që duhet të merren në analizë për të përcaktuar nëse një organ që vendos masat disiplinore ndaj gjyqtarëve është një organ i pavarur dhe i paanshëm. Në lidhje me kriterin e parë, përfaqësimin thelbësor të gjyqtarëve në organin disiplinor, rezultoi se anëtarët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet specifik *ad hoc* parlamentar dhe asnjë anëtar nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e zgjedhjes.

20.1. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit se asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e zgjedhjes, trupi gjykues thekson se Kolegji në vendimmarrje të mëparshme të tij ka mbajtur qëndrimin se, sipas parashikimeve të dispozitave kushtetuese, Komisioni është një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili kryen rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure, e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, shkronja “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur komisionerë. Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet [...]. Për sa më sipër, ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet se nuk qëndron.*

21. Sipas subjektit të rivlerësimit ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, si dhe nenit 52, pika 1 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendon se në vendimin nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit, janë cenuar disa parime të procesit të rregullt ligjor si parimi i arsyetimit të vendimit, parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, parimi i prezumimit të fajësisë, parimi i pavarësisë dhe paanësisë, parimi i ligjshmërisë, parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe parimi se ligji nuk ka efekt prapaveprues.

21.1. Lidhur me sa parashtroi subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se, përveç faktit se subjekti nuk ka referuar të dhëna konkrete për disa nga shkeljet e pretenduara, pretendimet për



shkelje të parimit të prezumimit të fajësisë apo të parimit se ligji nuk ka efekt prapaveprues i përkasin fushës së të drejtës penale dhe proceseve me karakter penal dhe, si të tilla, nuk mund të shqyrtohen në kuadër të procesit të rivlerësimit. Për sa u përket pretendimeve të tjera për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, ato janë shqyrtuar në vazhdim të këtij vendimi, sipas shkaqeve të ankimit të paraqitura nga subjekti për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

22. Subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit ka pretenduar shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, pasi nuk është dëgjuar drejtësisht në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Sipas tij, Komisioni, sipas parashikimeve të nenit 87² të Kodit të Procedurave Administrative, para se të merrte vendimin përfundimtar, në garantim të së drejtës për të paraqitur prova dhe për t'u dëgjuar efektivisht, duhet të njoftonte subjektin duke i bërë të ditur provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative që praktikisht do të thotë t'i bënte me dije situatën e gjetjeve që mund të shkaktonin marrjen e masës disiplinore ose e thënë ndryshe t'i kalonte barrën e provës, si dhe duke i bërë me dije subjektit se cilat shkelje të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 dyshohet të jenë kryer nga subjekti. Subjekti i rivlerësimit pretendon se trupi gjykues i Komisionit nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka vlerësuar provat e paraqitura prej tij. Komisioni në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk ka vlerësuar pretendimet subjektit të rivlerësimit as gjatë hetimit administrativ dhe as gjatë seancave dëgjimore, të cilat kanë qenë tërësisht formale. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kopjen e raportit të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe analizën financiare të ribërë nga Komisioni pas seancës dëgjimore të datës 23.09.2022 dhe, më pas, pas shpalljes së vendimit, akte të cilat, sipas përgjigjes së datës 08.11.2022 të Komisionit, nuk i janë vënë në dispozicion. Komisioni nuk ka marrë vendim për administrimin ose jo të provave të paraqitura nga subjekti, si dhe në vendimin përfundimtar nuk ka arsyetuar vlerën provuese të provave të paraqitura prej tij.

22.1. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit për njoftimin nga Komisioni të provave dhe rezultateve të hetimit, pas verifikimit të akteve në fashikujt e Komisionit, konstatohet se subjekti është njoftuar me e-mail në datën 01.09.2022 se trupi gjykues ka përfunduar hetimin administrativ dhe është ftuar të njihet me dosjen dhe të marrë kopje të saj. Në këtë njoftim, Komisioni i ka bërë të ditur subjektit të drejtën për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse në këtë drejtim. Gjithashtu, subjekti është njoftuar se mund të njihet me dosjen dhe të paraqesë prova/shpjegime me shkrim lidhur me rezultatet e hetimit, brenda datës 16.09.2022. Subjektit i janë dërguar bashkëlidhur dhe rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, Komisioni i ka bërë me dije situatën për të cilën ai duhet

² Neni 87- Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar: "1. Përpara se të merrret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; c) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merrret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm".



të jepte shpjegime apo sillte prova. Nga përmbajtja e aktit "Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond Shytko", rezulton se për çdo gjetje Komisioni, pasi ka evidentuar problematikën e konstatuar dhe mungesën e dokumentacionit provues, në fund është shprehur: "Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, ju njoftojmë se keni barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 5 e Nenit D të Kushtetutës".

22.2. Në vazhdim të procedurës, në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, subjekti është njoftuar elektronikisht nga Komisioni dhe është ftuar në seancë dëgjimore në datën 23.09.2022, në të cilën i është dhënë mundësia të japë sërish shpjegime e të paraqesë prova për gjithçka që ka vlerësuar të nevojshme të dëgjohet, referuar gjetjeve për të cilat Komisioni formalisht i ka kaluar më parë barrën e provës.

22.3. Nga aktet e cituara më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni në kuptim e zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, ndryshe nga sa pretendon subjekti, ka realizuar detyrimin e tij si organ administrativ duke garantuar të drejtën e subjektit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, si dhe për të paraqitur prova dhe argumente lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar nëpërmjet komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, për të cilat ai duhet të jepte shpjegime apo sillte prova, duke i kaluar formalisht barra e provës, në zbatim e kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2006.

22.4. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson të pabazuar dhe pretendimin e subjektit se Komisioni duhet të bënte me dije situatën e gjetjeve që mund të shkaktonin marrjen e masës disiplinore. Nga akti i rezultateve të hetimit rezulton se në këtë dokument janë pasqyruar gjithë gjetjet e Komisionit, për të tri kriteret e vlerësimit, duke dhënë për çdo gjetje konstatimet e faktit dhe aktet mbi të cilat janë bazuar. Për çdo gjetje, subjekti është orientuar nga Komisioni që ka barrën e provës për të provuar të kundërtën. Subjekti, duke u njohur me rezultatet e hetimit paraprak, ka pasur mundësinë të perceptojë se cili është konkluzioni i rezultateve paraprake të hetimit, për të cilat duhet të paraqiste shpjegime dhe prova, në rast të mosdakordësisë dhe kundërshtimit të tyre.

22.5. Trupi gjykues çmon se nuk qëndron dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet t'i kishte bërë me dije se cilat shkelje të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 dyshohej të ishin kryer prej tij. Dispozitat kushtetuese dhe ligji nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë se si kryhet procesi i rivlerësimit, kriteret për të cilat bëhet ky proces, aktet mbi të cilat bazohet, si dhe mënyrën e deklaramentit dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Kuadri ligjor për rivlerësimin ka të përcaktuara qartë rastet kur mospërmbushja e detyrimeve nga subjektet apo pasaktësitë, deklaramentet e pamjaftueshme apo jo me vërtetësi të interesave pasurore dhe të të dhënave për kontrollin e figurës, përbëjnë shkaqe për dhënien e masave disiplinore, të cilat, gjithashtu, janë të përcaktuara qartë për çdo shkelje. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit nuk mund të priste që Komisioni ta orientonte apo përcaktonte se cilat ishin shkeljet e mundshme që ai mund të kishte kryer, pasi si një jurist profesionist ai vetë duhet të ishte i vetëdijshëm për rezultatet apo pasojat që do të vinin në kuadër të deklaramentit prej tij dhe verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni apo në rast mungese të shpjegimeve apo paraqitjes së provave, që mund të passillnin vendosjen e një mase disiplinore. Për më tepër, parapërcaktimi



nga Komisioni i një baze ligjore për shkelje të mundshme nga ana e subjektit³ në fazën e hetimit, para shqyrtimit në tërësi të çështjes, do ta paragjykonte procesin ndaj tij.

23. Trupi gjykues vlerëson si të pabazuara në fakte pretendimet e subjektit se Komisioni në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, pasi referuar përmbajtjes dhe në analizë të vendimit të Komisionit vërehet se në tërësinë e tij janë pasqyruar aktet e sjella si prova mbi të cilat subjekti ka mbështetur argumentet e tij. Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimin të tij provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit, të atyre të cilat janë çmuar prej tij dhe me ndikimin apo efektin që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit *organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.*
24. Në përfundim të sa analizuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se janë të pambështetura në fakte dhe në provat e administruara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit ndaj tij ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor.
25. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin e të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues vlerëson se tashmë Kolegji ka krijuar një jurisprudencë⁴ të konsoliduar në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe të figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Sipas interpretimit të Kolegjit është e panevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen këtë pretendim të pabazuar në ligj dhe, si i tillë, ai nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
26. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se në seancën dëgjimore të datës 23.09.2022 konstatohen shkelje procedurale të kryera nga ana e trupit gjykues, si dhe nga ana e vëzhguesit

³ Shiko dhe vendimin e GjEDNj-së Xhoxhaj kundër Shqipërisë, sipas të cilit: "308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së".

⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; nr. 7 (JR), datë 05.04.2019; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019, nr. 35 (JR), datë 22.09.2022, etj.



ndërkombëtar deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Gjatë kësaj seance, vëzhguesi ndërkombëtar, pa komunikuar me trupin gjykues, është larguar nga salla e gjykimit duke sjellë ndërprerjen e seancës. Më vonë në sallë paraqitet një tjetër vëzhgues ndërkombëtar, por përsëri seanca nuk ka filluar për shkak se mungonin përkthyesit. Në seancën e datës 28.09.2022, për shpalljen e vendimit prezent ka qenë një tjetër vëzhguese ndërkombëtare, e cila nuk kishte mundësi për të njohur dosjen e rivlerësimit. Subjekti parashtron se është i paqartë se cili nga tre vëzhguesit ndërkombëtarë ka qenë prezent në dhomën e këshillimit, kur është diskutuar vendimmarrja e Komisionit. Referuar parashikimeve ligjore për rolin e vëzhguesve të ONM-së roli dhe opinionet e tyre kanë qenë jo pak të rëndësishme në vendimmarrjet e Komisionit.

26.1. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit mbi rolin e vëzhguesit ndërkombëtar në procesin e vendimmarrjes së Komisionit, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji në vendimin nr. 11/2022 është shprehur se :“[...] trupi gjykues së pari vëren se nga leximi harmonik i dispozitave kushtetuese dhe ligjore, që normojnë rolin dhe detyrat ONM-së dhe vëzhguesve, rezulton qartë që vëzhguesit nuk kanë përgjegjësi të natyrës së ekspertit, të një pale në proces apo një anëtar të pavarur vendimmarrës. ONM-ja kryen monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit. Nëpërmjet vëzhguesve, ky rol dybinarësh materializohet, ndër të tjera, në formën e gjetjeve dhe mendimeve, paraqitjes së rekomandimeve dhe aksesit të informacionit që lejojnë këto detyra në kohë reale dhe në të gjitha fazat⁵. [...] Procesi i rivlerësimit bazohet tërësisht në parimet e procesit të rregullt, të sanksionuara nga Kushtetuta dhe normat ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejt nga gjykatat në Shqipëri, përfshirë edhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Për sa më sipër, në kushtet kur vëzhguesit ndërkombëtarë nuk luajnë rolin e ekspertit apo të palës në proces, duke pasur parasysh mbi të gjitha ngritjen e rolit të tyre në nivel kushtetues, trupi gjykues çmon se problematikat e konstatuara në shkëljet e nenit 6 § 1 nga GjEDNj-ja, për shkëlje të gjykimit kontradiktor apo të pamjes së mungesës së paanësisë, ndër të tjera në Kress dhe Martinie, nuk mund të argumentohet se gjejnë zbatim në procesin e rivlerësimit. [...] Po ashtu, në procesin e subjektit të rivlerësimit janë përfshirë vëzhgues të ndryshëm ndërkombëtarë, përfshirë edhe në seancën gjyqësore në Kolegj. Për rrjedhojë, edhe nëse analizohen konkluzionet e GjEDNj-së në çështjen Kress në një këndvështrim tejet garantist dhe që abstragon nga sa arsyetohet më sipër mbi dallimin esencial mes rolit të ONM-së edhe atij të ekspertit, nuk mund të argumentohet se vëzhguesi i caktuar në procesin gjyqësor në Kolegj, kishte shprehur mendime më parë për subjektin e rivlerësimit”.

26.2. Bazuar në parashikimet e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji, lidhur me rolin e vëzhguesve ndërkombëtarë në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se prania e disa vëzhguesve ndërkombëtarë në seancat e zhvilluara në Komision nuk ka prekur të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit dhe nuk përbën shkak për t’u konsideruar si shkëlje procedurale gjatë zhvillimit të këtyre seancave. Vëzhguesi ndërkombëtar nuk është palë në proces dhe roli i tij është ai i vëzhguesit dhe monitoruesit, që mund të ushtrohet ndër të tjera, në formën e gjetjeve dhe mendimeve, paraqitjes së rekomandimeve dhe aksesit të informacionit që lejojnë këto detyra në kohë reale dhe në të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, mbetet i paprovuar në

⁵ Neni B, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

fakte pretendimi i subjektit se me përjashtim të z. Teo Jacobs, vëzhguesit e tjerë nuk e njihnin dosjen e tij, pasi subjekti nuk paraqet ndonjë provë apo të dhënë për sa pretendon.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

- ***Për pasurinë apartament, me sip. 54,5 m², ndodhur në Pogradec, në vlerën 2.500.000 lekë, pasuri e fituar me dhurim***

27. Për këtë pasuri, Komisioni në vendimin përfundimtar ka konkluduar se: “[...], pasi administroi të gjitha aktet e depozituar nga subjekti, shqyrtoi dhe analizoi të gjitha provat dhe shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, ka arritur në konkluzionin se: - Subjekti arriti të provojë që kunati i tij ka qenë i punësuar në mënyrë të ligjshme (me kohë të pjesshme) pranë {***} dhe {***} dhe të ardhurat e ligjshme të përfituara nga ky punësim, të provuar me dokumentacion, janë në shumën 2.385 USD. - Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion punësimin e kunatit në {***} dhe as të ardhurat e ligjshme të përfituara nga ky punësim për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006.- Në përmbushje të detyrimit ligjor, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk mundi të provojë burimet e ligjshme të kunatit për blerjen e apartamentit në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë. [...] Në rastin e të ardhurave të përfituara nga punësimi i shtetasit M. Gj. pranë {***}, subjekti nuk arriti të provojë punësimin e tij në këtë institucion, e aq më pak pamundësinë objektive të këtij institucioni për të disponuar këto akte dhe arsyet e mosdisponimit të tyre mbi punësimin e këtij shtetasi dhe të ardhurat e përfituara nga ky punësim, në përputhje me detyrimin ligjor të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. [...] Në lidhje me shkakun e dhurimit të apartamentit nga kunati te subjekti dhe bashkëshortja e tij, për Komisionin mbetet e pa qartë arsyeja e dhurimit të apartamentit në pronësi të kunatit. Kjo paqartësi mbështetet në faktet se: - Shtetasi M. Gj. nuk dispononte asnjë pasuri tjetër të paluajtshme apo të luajtshme në Shqipëri, si automjet, depozita, bono thesari, etj. - Gjatë punësimit të shtetasit M. Gj. në Tiranë, ai ka banuar në qytetin e Mamurrasit, ndërkohë që blen një apartament në Pogradec, qytet në të cilin nuk e lidhte asgjë, përveç afërsisë me Korçën ku banonte e motra bashkë me subjektin e rivlerësimit. - Nga hetimi i Komisionit rezultoi se shtetasi M. Gj. nuk dispononte burime të mjaftueshme financiare për të blerë apartamentin në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë”.
28. Komisioni ka vlerësuar, gjithashtu, edhe mundësinë e blerjes së këtij apartamenti nga ana e subjektit në vitin 2007. Nga analiza financiare e përgjithshme e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme financiare për të blerë apartamentin në vitin 2007, në shumën 2.500.000 lekë.
29. Në përfundim Komisioni, nisur nga fakti i mungesës së dokumentacionit ligjor për të provuar të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, dhuruesit, që kishin shërbyer për blerjen e apartamentit në Pogradec në vitin 2007, fakt ky penalizues për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar se subjekti nuk provoi bindshëm burimet e ligjshme të dhuruesit për krijimin e pasurisë apartament në Pogradec, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.



30. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konkluzionet e Komisionit në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtron se:

30.1. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se personi tjetër i lidhur, M. Gj., nuk disponon burime të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë, subjekti parashtron se nga hetimi administrativ u provua se deri në vitin 2007 ai ka qenë i punësuar në disa organizma ndërkombëtarë dhe në subjektin privat {***}. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka pasaktësi për sa u përket llogaritjeve të të ardhurave të fituara nga kunati në bazë të kontratave të punësimit të dorëzuara si provë nga subjekti dhe të pranura nga Komisioni, pasi: (i) Janë dorëzuar si prova katër kontrata punësimi të kunatit në {***}, sipas të cilave rezultoi se ai ka marrë pagë mujore bruto 530 USD. Këto kontrata dhe kjo pagesë nuk janë marrë parasysh në të ardhurat e M. Gj. në {***} për zbritjen nga shuma 2.500.000 lekë. (ii) Në lidhje me punësimin në {***} dhe {***} (në vijim {***}), nga dokumentacioni i dorëzuar provohet se M. Gj. ka punuar për një vit në këto institucione, pa u përcaktuar paga mujore. Komisioni, pas vlerësimit të akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit lidhur me punësimet e kunatit të tij, ka konkluduar se janë dokumentuar të ardhura në total për vlerën 2.385 USD, të cilën më pas e ka zbritur nga shuma 2.500.000 lekë. Konstatohet se ka mangësi për llogaritja e bërë nga Komisioni, pasi shuma e fituar nga punësimi i tij në {***} dhe {***} është shumë herë më e lartë. (iii) Në arsyetimin e vendimit të Komisionit del se deri në datën 09.01.2007 rezultoi se shtetasi M. Gj. ka llogari në euro dhe në lekë pranë "Intesa Sanpaolo Bank", ku janë kryer disa transaksione në vitet 2003-2004 (tre transaksione në vitin 2003 në shumën totale 265.672 lekë dhe depozitë *cash* në shuma të vogla 121.652 lekë dhe 1.950 euro). Këto transaksione tregojnë se kunati ka pasur të ardhura e këto të ardhura janë krijuar nga puna e ligjshme që ai ka kryer, pavarësisht se objektivisht nuk ka qenë e mundur të mblidhej gjithë dokumentacioni për shkaqe që nuk vareshin prej tyre. Pra, konstatohet se të ardhurat e identifikuar në bankë, *cash* dhe transfertat bankare, nuk janë marrë parasysh për t'u llogaritur si të ardhura në blerjen e apartamentit në Pogradec. (iv) Në lidhje me të ardhurat e fituara nga kunati në "{***}" (televizioni "{***}") për periudhën prill 2005 deri në dhjetor 2006 me një pagë mujore 120.000-150.000 lekë, me gjithë kërkesën drejtuar këtij televizioni ende nuk kanë marrë përgjigje. Kunati M. Gj. ka punuar në televizionin "{***}" si drejtor marketingu për periudhën e përmendur më sipër, por për shkak të informalitetit që ka ekzistuar në vitet kur ka punuar kunati në këtë subjekt privat ka pamundësi objektive për të siguruar një kontratë apo vërtetim fakti mbi punën e kryer dhe pagën mujore të marrë.

31. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit për këtë pasuri, trupi gjykues nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit konstaton se:

31.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*: "Apartament banimi me sipërfaqe 54,5 m², regjistruar me numër pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, hipoteka Pogradec, fituar nga dhurimi i bërë nga vëllai bashkëshortes sime shtetasi M. Gj., sipas kontratës së dhurimit nr. {***} repertor e nr. {***} koleksion, datë 19.01.2009, dhuruar deklaruesit dhe bashkëshortes të tij. Vlera: 2.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%/50%".

Burimi i krijimit: "Fituar nga dhurimi i bërë nga vëllai bashkëshortes sime, shtetasi M. Gj., sipas kontratës së dhurimit nr. {***} repertor e nr. {***} koleksion, datë 19.01.2009, dhuruar



deklaruesit dhe bashkëshortes së tij". Tek të dhënat konfidenciale të bashkëshortes së subjektit në deklaratën vetting deklarohet: "M. Gj. është kunati i subjektit deklarues dhe njëkohësisht vëllai i J. Sh. (Gj.), bashkëshortja e subjektit deklarues. Është i datëlindjes 31.08.1979, beqar. Me arsim të lartë ka mbaruar studimet e nivelit universitar në Turqi dhe pasuniversitar në Zvicër. Ka punuar për disa organizata ndërkombëtare përfshi {***}, {***} dhe Zyra e {***}, në Tiranë, në vitin 2002-2004. Nga viti 2004 deri në 2007 drejtor i marketingut pranë "{***}". Nga 2007-2008 ka punuar për {***} Tiranë. Nga 2008-2009 studime në Zvicër. Në vitin 2009 deri 2012 pranë {***} në Gjenevë të Zvicrës dhe nga 2012 e në vazhdim pranë {***} në Bon të Gjermanisë. Llogari bankare në Deutsche Bank në Bon Gjermani me numër {***}. Kontratë punësimi datë 14.01.2015".

31.2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti ka deklaruar: "Shtëpi banimi 54,5 m², në Pogradec {***}, rr. {***}, e fituar sipas kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2009, tek noterit Bilisht J. G. dhuruar nga kunati im M. Gj. e 50% mua si deklarues dhe 50% bashkëshortes sime J. Sh. (Gj.) regjistruar Pogradec, me nr. pasurie {***} datë 21.1.09. Vlera: 2.500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%". Burimi i krijimit: "[...] fituar sipas kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2009, tek noterit Bilisht J. G. dhuruar nga kunati im M. Gj. e 50% mua si deklarues dhe 50% bashkëshortes sime J. Sh. (Gj.)".

31.3. Sipas kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2009, M. Gj. i ka dhuruar J. Sh. (Gj) dhe Edmond Shytko, apartamentin me sip. 54,5 m², në Pogradec, duke u shprehur se ia dhuron motrës dhe burrit të saj në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për gjithë kujdesin dhe ndihmën që ata në mungesë të nënës së tij i kanë dhënë deri në këtë moment.

31.4. Dhuruesi M. Gj. e ka përfituar apartamentin në Pogradec, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.01.2007, me blerës M. Gj. e shitës F. H., me vlerë prej 2.500.000 lekësh, çmim i cili ishte paguar përpara redaktimit të kontratës. Bashkë me kontratën subjekti ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës vetting dhe certifikatën e pronësisë së apartamentit të datës 26.01.2007.

31.5. Sipas procesverbalit të ILDKPKI-së të datës 14.01.2016, dërguar Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 06.06.2022, të këtij institucioni, subjekti i pyetur lidhur me përfitimin e apartamentit në Pogradec ka shpjeguar se lidhur me mënyrën e përfitimit si dhurim nga kunati ka dhënë sqarime e dokumente në procesverbalin e datës 14.09.2011, të ILDKPKI-së.

31.6. Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 14.09.2011, dorëzuar bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, subjekti i rivlerësimit i pyetur lidhur me arsyen e përfitimit me dhurim të apartamentit është shprehur se arsyeja e dhurimit është se në momentin kur është martuar me motrën e tij, dhuruesi (kunati i tij) ka qenë i vogël dhe në mungesë të nënës së tij, subjekti e bashkëshortja (motra e dhuruesit) janë përkujdesur për të e shkollimin e tij [...] ka qenë më tepër një detyrim moral i tij ndaj nesh. Ai aktualisht jeton e punon në {***} në Zvicër.

31.7. Me kërkesën e datës 19.09.2022, subjekti i është drejtuar televizionit {***} duke kërkuar një konfirmim/vërtetim për punësimin e M. Gj. për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006.



31.8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, lidhur me punësimin dhe të ardhurat e kunatit, ka paraqitur në Komision:

- i. vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 19.08.2022, i dokumentit njoftim kontrate të {***}, datë 31 dhjetor 2002⁶;
- ii. vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 19.08.2022, i dokumentit njoftim kontrate të {***}, datë 31 dhjetor 2002⁷;
- iii. vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 19.08.2022, i dokumentit njoftim kontrate të {***}, datë 31 dhjetor 2002⁸;
- iv. vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 19.08.2022, i dokumentit njoftim kontrate të {***}, datë 31 dhjetor 2002⁹;
- v. vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 19.08.2022, dokument i lëshuar nga {***}¹⁰; dhe
- vi. vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 19.08.2022, dokument i lëshuar nga {***}, i datës 18.07.2022¹¹.

32. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, me shkresën nr. {***}, datë 09.07.2020, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke kërkuar informacion për të dhënat tatimore (pagesat për sigurimet/tatim mbi të ardhurat personale, tatimin në burim dhe çdo lloj veprimi që përbën të dhënë tatimore), për subjektin e rivlerësimit dhe persona të tjerë të lidhur, midis tyre dhe për M. Gj.. Nuk rezulton nga aktet që Komisioni të ketë marrë një përgjigje zyrtare lidhur me informacionin e kërkuar¹².

33. Komisioni ka kërkuar të dhëna dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, lidhur me të ardhurat financiare të realizuara, midis të tjerëve dhe nga M. Gj.. Në përgjigjen e Drejtorisë së Arkivit të ISSh-së, dega Tiranë, me nr. {***} prot., datë 16.07.2020, është bërë me dije se nga mënyra e përpunimit të listëpagesave për periudhën 1994-2012 të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore juridike apo fizike, nuk mund të konfirmohen periudha kontributive apo paga mbi të cilat janë siguruar këto subjekte nëse nuk jepet dokumentacioni përkatës nga ana e subjektit

⁶ Nga ky akt rezulton se shtetasi M. Gj. ka qenë i punësuar/kontraktuar për periudhën 25 nëntor 2002 deri në 31 dhjetor 2002, me kohë të plotë, me një pagë mujore bruto 530.00 USD.

⁷ Nga ky akt rezulton se shtetasi M. Gj. ka qenë i punësuar për periudhën 01 janar 2003 deri në 01 mars 2003, me kohë të plotë, me një pagë mujore bruto 530.00 USD.

⁸ Nga ky akt rezulton se shtetasi M. Gj. ka qenë i punësuar për periudhën 02 mars 2003 deri në 31 mars 2003, me kohë të plotë me një pagë mujore bruto 530.00 USD.

⁹ Nga ky akt rezulton se shtetasi M. Gj. ka qenë i punësuar për periudhën 01 prill 2003 deri në 14 prill 2003, me kohë të plotë me një pagë mujore bruto 530.00 USD.

¹⁰ Ky dokument vërteton se M. Gj. ka qenë i emëruar në datën 05.04.2004 dhe emërimi më i fundit për periudhën 03.12.2004 deri në 15.01.2005 ka qenë i përkohshëm (sipas aktit të limituara në 150 ditë për vit fiskal), por nuk ka të dhëna për pagesën.

¹¹ Dokumenti vërteton se M. Gj. ka qenë i punësuar nga {***} në Shqipëri në periudhat : 1 gusht 2003 - 31 tetor 2003, në kontratën {***}, si Asistent koordinator Rajonal për zyrën e {***} në Tiranë; 15 qershor 2007 - 14 shtator 2007, në marrëveshjen e Shërbimeve Speciale si Asistent i Ndërgjegjësimit Publik ose informacionit për projektin {***}; 10.03.2008 – 23.03.2008, në Marrëveshjen e Shërbimeve Sociale si Interpretues për projektin {***}; 14 prill 2008 - 4 maj 2008, në Marrëveshjen e Shërbimeve Sociale si konsulent i Informacionit Publik për Projektin {***}.


¹² Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.07.2020, ka dërguar të dhëna vetëm për subjektin e rivlerësimit.



kërkues lidhur me qendrën e punës, NIPT-in e subjektit apo fotokopje e librezës së punës. Nga ky institucion në vazhdim është dhënë informacion vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe vjehrrin e tij F. Gj..

34. Në përmbledhje të asaj që ka konkluduar Komisioni në vendim për këtë pasuri, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk ka arritur të provojë bindshëm burimet e ligjshme të dhuruesit për krijimin e pasurisë apartament në Pogradec, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi: nuk arriti të provojë me dokumentacion punësimin e kumatit në {***} dhe as të ardhurat e ligjshme të përfituara nga ky punësim për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006; për punësimin në institucionet e huaja, subjekti arriti pjesërisht të depozitonte dokumentacion provues mbi punësimet e dhuruesit, kumatit të tij; mbetet e paqartë arsyeja e dhurimit, pasi shtetasi M. Gj. nuk dispononte pasuri tjetër, banonte në Mamurras dhe punonte në Tiranë, pa lidhje me qytetin e Pogradecit. Subjekti në përmbushje të detyrimit ligjor, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nuk mundi të provojë burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur, kumatit të tij, për blerjen e apartamentit në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë.
35. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit, për sa u përket të ardhurave të punësimin të personit tjetër të lidhur, kumatit në {***}, për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006¹³, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur barrën e provës për të provuar me dokumentacion pretendimet e tij lidhur me të ardhurat e personit tjetër të lidhur, kumatit dhe ka qenë i njohur me këtë detyrim që në pyetësorin nr. 2, në të cilin, në pyetjen nr. 6, i janë kërkuar nga Komisioni sqarime, pasi: *“Në lidhje me apartamentin e përfituar me kontratë dhurimi nga kunati juaj, M. Gj. në janar 2009, nga hetimi dhe dokumentacioni i administruar nga Komisioni, duket se nuk janë provuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Sa më sipër, provoni me dokumentacion të ardhurat e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Kushtetutës që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në janar të vitit 2007 nga ky shtetas”*.
36. Konstatohet, sipas aktit të depozituar në Komision në kuadër të rezultateve të hetimit, se subjekti i rivlerësimit i është drejtuar në datën 19.09.2022, me kërkesë televizionit {***}, duke kërkuar të dhëna mbi punësimin e kumatit M. Gj. për periudhën prill 2005 - dhjetor 2006. Përveç kërkesës me shkrim drejtuar subjektit privat, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në Komision asnjë dokument tjetër që do të provonte të paktën punësimin e kumatit për periudhën për të cilën pretendohet. Vetëm pas ankimit në Kolegj, bashkëlidhur kërkesës së datës 10.08.2023, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një vërtetim, mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për punësimin në televizionin {***}, të dhënë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega e Arkivit të Rajonit Tiranë me shkresën nr. {***} prot., datë 14.06.2023. Në këtë vërtetim jepen të dhëna mbi të ardhurat mbi bazën e të cilit është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore për periudhën gusht 2004-shtator 2006, por nuk ka të dhëna lidhur me të ardhurat që ka realizuar M. Gj. nga paga, që sipas subjektit të rivlerësimit pretendohet të ketë qenë 120.000-150.000 lekë në muaj. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se me paraqitjen e këtij vërtetimi, rezulton i paprovuar dhe deklarativ

¹³ Në deklaratën vetting bashkëshortja e subjektit deklaroi se M. Gj. ka qenë i punësuar nga viti 2004 deri në 2007 drejtor i marketingut pranë {***}.



pretendimi i subjektit se ka qenë objektivisht e pamundur dhe se nuk ka arritur të sigurojë të dhëna për punësimin për shkak të kohës së largët, si dhe informalitetit që ka ekzistuar në vitet kur ka punuar kunati në këtë subjekt privat. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë për t'iu drejtuar më parë ISSh-së për paraqitjen e këtij akti gjatë procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision.

37. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e personit tjetër të lidhur, dhuruesit, nga punësimi në {***} dhe mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit që nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga ky punësim, për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006.
38. Për sa u përket marrëdhënieve të punës me disa institucione ndërkombëtare për periudhën 2002-2008, nga aktet në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues vëren se subjekti ka sjellë disa vërtetime punësimi, por konstaton se periudhat e punësimit sipas këtyre akteve nuk e mbulojnë gjithë periudhën kohore të pretenduar nga subjekti. Konkretisht, konstatohet se ndërsa subjekti pretendon se kunati i tij ka qenë i punësuar për periudhën korrik 2003 - mars 2004 pranë {***}, nga ky institucion, me vërtetimin e datës 18.07.2022, konfirmohet punësimi i z. M. Gj., për periudhën 01.08.2003 - 31.10.2003 (91 ditë), si dhe për periudhat 15.06.2007 - 14.09.2007 (91 ditë), 10.03.2008 - 23.03.2008 (13 ditë) dhe 14.04.2008 - 4.05.2008 (21 ditë). Për punësimin pranë {***}, ndërsa subjekti ka pretenduar periudhë punësimi nga muaji maj 2004 deri në shkurt 2005, nga vërtetimi i datës 02.03.2022, lëshuar nga ky institucion, rezulton se z. M. Gj. është emëruar në datën 05.04.2004 dhe emërimi i fundit ka qenë për periudhën 03.12.2004 - 15.01.2005, me kohë të përkohshme (sipas aktit të limituar në 150 ditë për vit fiskal). Ndërsa, për punësimin në {***}, ndërkohë që subjekti ka deklaruar periudhën shtator 2002 -maj 2003, nga vërtetimi i datës 31.12.2002, i këtij institucioni, rezulton se ai ka qenë i punësuar pa ndërprerje për periudhën 25.11.2002 - 01.03.2003 dhe më pas me kontrata për periudhën 02.03.2003 - 31.3.2003 (29 ditë) dhe 01.04.2003 - 14.4.2003 (14 ditë).
39. Komisioni në vendim, pas vlerësimit të akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit lidhur me punësimet e kunatit të tij, ka konkluduar se: *“Subjekti arriti të provojë që kunati i tij ka qenë i punësuar në mënyrë të ligjshme (me kohë të pjesshme) pranë {***} dhe {***} dhe të ardhurat e ligjshme të përfituara nga ky punësim, të provuar me dokumentacion, janë në shumën 2.385 USD”*. Nga verifikimi i akteve të sipërcituara, trupi gjykues konstaton se është i gabuar referimi nga Komisioni për të ardhura nga punësimi pranë {***} dhe {***}, pasi nga aktet rezulton se subjekti ka arritur të provojë pagesat nga punësimi dhe pagën përkatëse vetëm për periudhën e punës pranë {***}, sipas dokumentit të lëshuar nga ky institucion me pagë mujore bruto 530 USD, që i korrespondon vlerës prej 2.385 USD të llogaritur nga Komisioni¹⁴. Për këtë arsye, është i pabazuar dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit që ka kundërshtuar llogaritjen nga Komisioni të të ardhurave nga punësimi i kunatit, por për shkak dhe në vazhdim të lapsusit në vendimin e

¹⁴ Si total i: (i) 530 USD lidhur me kontratën për periudhën 25.11.2002 - 31.12.2002; (ii) 1.060 USD (530 USD x 2 muaj) lidhur me kontratën për periudhën 01.01.2003 - 01.03.2003; (iii) 530 USD lidhur me kontratën për periudhën 02.03.2003 - 31.03.2003; (iv) 265 USD (530 USD / 2 pasi është për 14 ditë punë) lidhur me kontratën për periudhën 01.04.2003 - 14.04.2003.



Komisionit ka konsideruar gabim llogaritjen e shumës 2.385 USD si llogaritje nga punësimi në {***} dhe {***}, si dhe ka kërkuar përfshirjen në analizën financiare të personit të lidhur të ardhurat nga punësimi në Këshillin e Evropës.

40. Trupi gjykues konstaton se për punësimet me kohë të pjesshme të personit tjetër të lidhur, M. Gj., në {***} dhe {***}, për të cilat vërtetohen marrëdhëniet e punësimit por jo pagesat, subjekti i rivlerësimit ngre si shkak ankimi dhe kërkon përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizë, pa pretenduar për një vlerë konkrete. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në Komision nuk vërtetojnë pagesat mbetet e bazuar për llogaritja nga Komisioni, i cili ka konsideruar si të ardhura nga punësimi vetëm ato të përfituara në {***}, për të cilat referohen dhe pagat respektive, në vlerën 2.385 USD (ose ekuivalenti 290.646 lekë).
41. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se ka pasaktësi në për llogaritjen e të ardhurave të personit tjetër të lidhur nga Komisioni, pasi, ashtu si dhe është konstatuar nga ky i fundit në vendim, rezulton se kunati i tij deri në datën 09.01.2007 ka pasur llogari në euro dhe në lekë pranë "Intesa Sanpaolo Bank"¹⁵, si dhe ka kryer transaksione që tregojnë se ka pasur të ardhura nga puna e ligjshme. Të ardhurat e identifikuar në bankë *cash*, si dhe transfertat bankare nuk janë marrë parasysh nga Komisioni për t'u llogaritur si të ardhura në blerjen e apartamentit në Pogradec.
42. Në analizë të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit, pasi *së pari*, lidhur me depozitimet dhe transaksionet në lekë dhe në euro nga M. Gj., të evidentuara nga Komisioni në llogarinë e tij në "Intesa Sanpaolo Bank" në vitet 2003-2004, konfirmuar dhe nga Kolegji, konstatohet se vlera prej 1.950 eurosh lidhet me depozitime të kryera në datën 11.09.2007, pas blerjes së apartamentit në datën 09.01.2007. Nga këto depozitime nuk evidentohet asnjë e dhënë për të ardhura nga punësimi, të provuara me akte dhe, për pasojë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura që provojnë mundësinë e personit tjetër të lidhur për blerjen e apartamentit. *Së dyti*, lidhur me tri transfertat në llogarinë e M. Gj. evidentuar nga Komisioni në llogarinë e tij në "Intesa Sanpaolo Bank", në 2003, konfirmuar dhe nga Kolegji, në vlerën totale prej 265.672 lekësh, për dy transfertat në total prej 178.880 lekësh (të kryera në datat 01.10.2003 dhe 24.11.2003), nuk identifikohet dërguesi. Për transfertën prej 86.792 lekësh (në datën 18.12.2003), me përshkrimin "*Transfer with check M. Gj./ trans from {***} to M. Gj.*" prezumohet se është kryer si rezultat i punësimit pranë {***}.
43. Sa më sipër, depozitimet dhe transaksionet në llogaritë bankare të M. Gj. në "Intesa Sanpaolo Bank", të evidentuara nga Komisioni, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk përbëjnë të ardhura të cilat Komisioni duhet t'i kishte llogaritur për të vlerësuar mundësinë e blerjes së apartamentit në janar të vitit 2007. Ndërsa referuar transfertës së evidentuar në vlerën prej 86.792 lekësh me dërgues {***}, që nuk mund të lidhet direkt me punësimin që personi tjetër i lidhur ka pasur, sipas vërtetimit me {***} për periudhën 01.08.2003 - 31.10.2003, trupi gjykues vëren se edhe nëse konsiderohet, kjo e ardhur nuk do të ndryshonte rezultatin në analizën financiare.

¹⁵ Ku janë kryer disa transaksione në vitin 2003-2004 (tre transaksione në vitin 2003 në shumën totale 265.672 lekë dhe depozitë *cash* në shuma të vogla 121.652 lekë dhe 1.950 euro).



44. Për sa i përket shkakut të ankimit, lidhur me konsiderimin e transaksioneve bankare në llogaritë e personit tjetër të lidhur, në Kolegj u verifikuan lëvizjet e llogarive bankare në BKT, për transaksionet në këtë bankë, nga të cilat konfirmohen pagesat nga {***}, por në vlerë më të vogël se ato të përlllogaritura referuar kontratave.
45. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e provuara nga personi tjetër i lidhur, kunati i subjektit të rivlerësimit, në vlerën 2.385 USD (ose 290.646 lekë)¹⁶, nuk mbulojnë blerjen e apartamentit prej 2.500.000 lekësh, në Pogradec, në datën 09.01.2007, si dhe shpenzimet e jetesës.
46. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se mbetet e paqartë arsyeja e dhurimit, konstatohet se Komisioni ka arritur në këtë përfundim mbështetur në faktet se: (i) *Shtetasi M. Gj. nuk dispononte asnjë pasuri tjetër të paluajtshme apo të luajtshme në Shqipëri;* (ii) *Gjatë punësimit në Tiranë, ai ka banuar në qytetin e Mamurrasit, ndërkohë që blen një apartament në Pogradec, qytet në të cilin nuk e lidhte asgjë, përveç afërsisë me Korçën ku banonte e motra bashkë me subjektin e rivlerësimit.* (iii) *Nga hetimi i Komisionit rezultoi se shtetasi M. Gj. nuk dispononte burime të mjaftueshme financiare për të blerë apartamentin në Pogradec, në shumën 2.500.000 lekë.*
47. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar gjatë hetimit administrativ në Komision, siç dhe përsërit në ankimin dhe në parashtrimet në Kolegj, se janë marrëdhëniet e ngushta dhe në kushte të veçanta familjare, si dhe fakti që kunati i subjektit është larguar për të punuar dhe jetuar jashtë vendit, që kanë ndikuar në vendimin për dhurimin e apartamentit prej këtij të fundit. Sipas subjektit, është një interpretim i gabuar i rrethanave një nga shkaqet që e ka çuar Komisionin në paqartësinë në arsyen e dhurimit të apartamentit.
48. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se është i bazuar pretendimi për një lapsus në arsyetimin e Komisionit sa i përket dhurimit. Në vendim Komisioni shprehet: *“Në vijim, shtetasi M. Gj., me kontratën e dhurimit nr. {***}, datë 19.01.2009, ia dhuron apartamentin motrës dhe bashkëshortit Edmond Shytko, në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për të gjithë kujdesin ndaj nënës dhe ndihmën e tyre të dhënë deri në atë moment, në mungesë të tij”*. Ashtu si me të drejtë ka konstatuar subjekti i rivlerësimit në ankim, ky formulim është ndryshe nga sa ka deklaruar kunati i tij, M. Gj., në kontratën e dhurimit, se: *“Dhuruesi me ndërgjegje e vetëdije të plotë i pashtrenguar nga askush deklaroi se sendin si më sipër objekt dhurimi ia dhuron motrës e burrit të saj në shenjë mirënjohjeje e respekti për gjithë kujdesin dhe respektin që ata, në mungesë të nënës së tij, i kanë dhënë deri në këtë moment”*.
49. Komisioni, në përfundim për këtë pasuri, ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur që ka bërë dhurimin. Pavarësisht këtij konkluzioni, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka analizuar dhe konsideruar gjithashtu dhe mundësinë e blerjes së kësaj pasurie nga vetë subjekti. Nga analiza financiare e përgjithshme e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme financiare për të blerë apartamentin në vitin 2007, në shumën 2.500.000 lekë.

¹⁶ Ose 377.438 lekë, duke konsideruar dhe vlerën e kaluar në llogarinë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 18.12.2003 prej 86.792 lekësh me dërgues {***}.



50. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë pretendimet e tij lidhur me shkaqet e blerjes dhe dhurimit të apartamentit prej kunatit M. Gj. dhe krijon bindjen se rrethanat faktike çojnë drejt argumentimit të dyshimit se pasuria apartament mund të jetë faktikisht një pasuri e blerë nga vetë subjekti i rivlerësimit. Prandaj vlerësohet se qëndrimi i Komisionit mbi shkaqet e dhurimit të kësaj pasurie, rezulton i bazuar në situatën faktike.
51. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, dhuruesit M. Gj., që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2007. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm burimet financiare të ligjshme të dhuruesit për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- Për pasurinë apartament, me sipërfaqe 91,88 m², blerë në shumën 8.450.000 lekë, në vitin 2012, lidhur me burimin e deklaruar “hua pa interes në shumën 15.000 euro, marrë vëllait dhe bashkëshortes së tij”

52. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament banimi në Tiranë, me sipërfaqe 91,88 m², e regjistruar numër pasurie {***} ndodhur në zonën kadastrale {***}, hipoteka Tiranë, fituar sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} repertor e nr. {***} koleksion, datë 05.07.2012, me shitës A. L. banues Tiranë dhe blerës Edmond Shytko e J. Sh.. Kjo blerje ka ardhur nga kursimet në lekë të mbledhura në vite në shumën 2.921.954 lekë, marrë hua pa interes bashkëshortja e subjektit deklarues te vëllai i deklaruesit L. Sh. në shumën 15.000 euro, marrë hua pa interes bashkëshortja e subjektit deklarues te vëllai i saj dhe njëkohësisht kunati i deklaruesit, z. M. Gj., në shumën 25.000 USD dhe 5.700 euro. Pjesa takuese: 50%/50%. Burimi: (i) kursime në shumën 2.921.954 lekë të mbledhura ndër vite; (ii) hua pa interes në shumën 25.000 USD dhe 5.700 euro, marrë kunatit M. Gj.; (iii) hua pa interes në shumën 15.000 euro, marrë vëllait L. Sh.”.
53. Në rubrikën “Detyrime financiare” në deklaratën vetting, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Marrje huaje në euro pa interes, marrë nga bashkëshortja e deklaruesit me dijeninë e tij, te kunata dhe vëllai i deklaruesit M. dhe L. Sh., me qëllim blerje shtëpi banimi në Tiranë. Shuma totale prej 15.000 eurosh tërhequr pranë Bankës Kombëtare Tregtare, dega Korçë, në datën 02.07.2012, mbështetur në prokura e posaçme nr. {***} repertor dhe nr. {***} kolektor, datë 23.06.2012, para noterit J. Gj., zyra e noterisë Bilisht Devoll. Afati i shlyerjes së detyrimit është 10 (vjet), duke filluar nga data 13.07.2012. Vlera e mbetur 6.000 euro”.
54. Tek të dhënat konfidenciale në deklaratën vetting, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “L. Sh. dhe M. Sh. janë vëllai dhe kunata e subjektit deklarues. Që nga viti 1999 e vazhdim të dy së bashku kanë emigruar në shtetin Grek dhe vazhdojnë të jetojnë aty së bashku tashmë me dy fëmijët e tyre të lindur në Greqi. Kanë jetuar dhe jetojnë në qytetin e Kozanit Greqi. Nga puna e tyre ata kanë fituar të ardhura të cilat i kanë depozituar në Bankën Kombëtare Tregtare, dega Korçë, si dhe kanë në pronësinë e tyre një shtëpi banimi, po në qytetin e Korçës. Këto pasuri të fituara pasqyrohen me dokumentet bashkëngjitur deklarimit. Deklarimi i të ardhurave të fituara në shtetin



*Grek nga viti 2002-2016. Depozitime në BKT, dega Korçë, shtëpi banimi regjistruar pranë hipotekës Korçë, numër pasurie {***}”.*

55. Në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Në DPV-në 2012: *“Shtesë gjatë vitit 2012: shtëpi banimi me sip. 91,88 m², me adresë Rruga {***}, ap. {***}, godina {***}, kati {***}, në Tiranë. Blerë në datën 05.07.2012. Burimet janë kursimet familjare në familjen time dhe marrje huaje te M. Gj. (kunati) dhe L. e M. Sh. (vëllai dhe kunata ime). Vlera: 8.450.000 lekë. Pjesa takuese: 50%/50%. Në seksionin detyrime subjekti deklaroi marrje hua në euro pa interes marrë nga bashkëshortja e deklaruesit me detyrimin e tij, te kunata dhe vëllai i deklaruesit, M. dhe L. Sh., me qëllim blerje shtëpi banimi në Tiranë. Eurot janë tërhequr në BKT. Fillimi i detyrimit është data 13.07.2012. Afati i kthimit të huasë është 10-vjeçare. Vlera 15.000 euro * 138.3 lekë = 2.074.500 lekë”.*
- Në DPV-në 2013: *“Marrje hua në vitin 2012 nga bashkëshortja e deklaruesit të shumës prej 15.000 eurosh (shih deklarinë e vitit 2012) shuma e shlyer 3.000 euro. Mbetur për t'u shlyer 12.000 euro. Dorz. Fizik te M. & L. Sh.”.*
- Në DPV-në 2014: *“Marrje hua në vitin 2012 nga bashkëshortja e deklaruesit për blerje banese, në shumën prej 15.000 eurosh te M. e L. Sh. (vëllai i bashkëshortit). Tërhequr në BKT në datën 02.07.2012 afat shlyerje 10 vjet. Aktualisht jetojnë në Greqi. Shuma e shlyer 1.000 euro. Mbetur për t'u shlyer 11.000 euro”.*
- Në DPV-në 2015: *“Marrje hua në vitin 2012 nga bashkëshortja e deklaruesit për blerje banese, në shumën prej 15.000 eurosh te M. e L. Sh. (vëllai i bashkëshortit). Tërhequr në BKT në datën 02.07.2012 afat shlyerje 10 vjet. Aktualisht jetojnë në Greqi. Shuma e shlyer 5.000 euro. Mbetur për t'u shlyer 6.000 euro”.*
- Në DPV-në 2016: *“Marrje hua në vitin 2012 nga bashkëshortja e deklaruesit për blerje banese, në shumën prej 15.000 eurosh te M. e L. Sh. (vëllai i bashkëshortit). Tërhequr në BKT në datën 02.07.12 afat shlyerjeje 10 vjet Shuma e shlyer 5.000 euro. Mbetur për t'u shlyer 6.000 euro”.*
56. Komisioni në vendim, lidhur me burimin e blerjes së apartamentit nga huaja e dhënë nga shtetasit L. dhe M. Sh., ka konkluduar: *“Në lidhje me huanë në vlerën 15.000 euro, dhënë nga shtetasit L. dhe M. Sh., Komisioni, pas vlerësimit të pretendimeve dhe provave të depozituar nga subjekti, arsyeton se referuar pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që personat e lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave. Në lidhje me këtë hua, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka provuar marrëdhënien e huadhënies me vëllain dhe kunatën sipas deklaratë noteriale në datën 13.07.2012 dhe dhënia e huas është bërë me transaksion bankar. Në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësve, Komisioni mori në konsideratë provat e reja të sjella nga subjekti për burimet e ligjshme të huadhënësve, duke përfshirë të ardhurat e ligjshme të përfituara nga këta shtetas në analizën financiare referuar akteve. Komisioni përfshiu në analizën financiare, të kryer pas prapësimeve, të ardhurat shtesë të përfituara nga familja e vëllait, si kompensim dhënë nga shteti grek në shumën totale 16.859 euro. Nga kjo analizë, huadhënësi rezultoi sërish me balancë negative. Pra, nga analiza financiare e kryer rezultoi se huadhënësi nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të dhënë huanë në shumën 15.000 euro dhe për të përballuar shpenzimet e tij të jetesës, pasi nga analiza financiare e kryer për periudhën 2005 –*



2011 rezultoi balancë negative në shumën 21.182 euro. Për pasojë, shuma e huasë nuk u konsiderua si burim i ligjshëm në analizën përfundimtare të kryer nga Komisioni”.

57. Komisioni në përfundim ka konkluduar se nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, në përputhje me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

58. Për pasurinë apartament banimi në Tiranë, subjekti në ankimin drejtuar Kolegjit pretendon se:

58.1. Nga ana e Komisionit është konkluduar se huadhënësit, vëllai dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të dhënë huanë në shumën 15.000 euro, pasi nga analiza financiare për periudhën 2005-2011 rezultoi bilanc negativ në shumën 21.182 euro. Konstatohet se nga Komisioni është kryer një analizë financiare duke përfshirë të gjithë pasurinë e L. dhe M. Sh. dhe jo vetëm shumën prej 15.000 eurosh të dhënë hua, objekt vlerësimi. Kjo nuk është në përputhje me parashikimet ligjore, në të cilën personi tjetër i lidhur, në këtë rast vëllai, është i detyruar të japë shpjegime deri në shumën e dhënë hua. Pra, vendosja e tij në kushtet e subjektit rivlerësues tejkalon parashikimet dhe detyrimet ligjore.

58.2. Gjithashtu, rezulton se Komisioni nuk ka bërë një analizë financiare të plotë dhe të gjithanshme, duke përfshirë dhe shumën në euro që vëllai dhe kunata kishin depozituar në BKT, dega Korçë, gjatë viteve 2010 e 2011, nga të cilat është bërë transfertë bankare duke u tërhequr ligjërisht nga bashkëshortja e subjektit J. Sh., shuma prej 15.000 eurosh. Nuk është marrë parasysh gjendja e llogarisë bankare të L. e M. Sh., në BKT, dega Korçë, deri në vitin 2012 kur është marrë hua nga ana e subjektit të rivlerësimit (shuma 30.643 euro). Nuk janë marrë parasysh dhe gjendja bankare e L. e M. Sh., në Bankën Kombëtare të Greqisë. Në llogaritjen e të ardhurave ato përlllogariten nga viti 2005, duke përjashtuar çdo lloj kursimi përpara këtij viti. Shuma prej 3.000 eurosh, që vëllai i ka dhënë si ndihmë për shkak të mbajtjes nga ana e subjektit të prindërve, është e ardhur nga tërheqjet që L. Sh. ka bërë nga llogaria e tij në Bankën Kombëtare të Greqisë në vitin 2007 dhe konkretisht në shumat 4.800 euro më 05.07.2007 dhe 4.800 euro më 03.12.2007.

58.3. Nga vendimi rezulton që Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumën 16.859 euro si kompensim dhënë nga shteti grek për familjen e L. e M. Sh.. Në këndvështrimin e subjektit të rivlerësimit konstatohet se shuma 16.859 euro e marrë si kompensim nga vëllai e kunata ka qenë e mjaftueshme për të dhënë huanë 15.000 euro. Për periudhën 2005 - 2011 kompensimi nga shteti grek ka qenë në shumën 16.850 euro, të ardhura të cilat nuk janë të tatueshme dhe kanë kaluar çdo muaj në llogarinë bankare të huadhënësve. Këto shuma, sipas subjektit të rivlerësimit, kanë qenë të mjaftueshme për dhënien e huasë.

59. Trupi gjykues vëren nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, për të provuar dhënien e huasë, si dhe burimet e ligjshme të huadhënësve L. dhe M. Sh., ka depozituar në Komision aktet: (i) deklaratë noteriale, datë 13.07.2012, me palë shtetasit L., M. dhe J. Sh., me të cilën deklarojnë se kjo e fundit i ka marrë hua nëpërmjet prokurës së posaçme nr.



{***}, datë 23.06.2012, shumën 15.000 euro, për nevoja familjare, për efekt banimi. Kjo shumë do të kthehet në të njëjtën vlerë për një afat të pacaktuar, por jo më vonë se 10 vjet; (ii) mandat tërheqje bankare, datë 02.07.2012, lëshuar nga BKT-ja, me të cilin shtetasja J. Sh. ka tërhequr shumën 15.000 euro nga depozita me afat 6-mujor e shtetasve L. ose M. Sh.; (iii) vërtetim përkthimi nga gjuha greke, me nr. {***} rep., datë 24.12.2021, i dokumentit të lëshuar nga organet tatimore greke me përshkrimin “formular likuidimi i tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë mbi bazën e deklaratës fillestare”, për vitet 2003 – 2016. Bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, subjekti ka paraqitur në Komision edhe disa dokumente të përkthyer nga gjuha greke, me vërtetim përkthimi datë 14.09.2022, të cilat përshkruajnë lëvizje të llogarive bankare të L. e M. Sh. në Bankën Kombëtare të Greqisë

60. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit për analizën e kryer nga Komisioni, duke përfshirë të gjithë pasurinë e L. dhe M. Sh. dhe jo vetëm shumën prej 15.000 eurosh të dhënë hua, trupi gjykues sjell në vëmendje se neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në kuptim të dispozitave të mësipërme, konfirmohet statusi ligjor i vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si persona të tjerë të lidhur, në cilësinë e huadhënësit, në bazë të deklaratimit nga vetë subjekti, si dhe vërtetohet marrëdhënia e huadhënies bazuar në deklaratën noteriale dhe mandatin e tërheqjes bankare.
61. Nga vendimi i Komisionit rezulton se në analizën financiare për L. e M. Sh. për periudhën 2005-2011, për mundësinë e dhënies së huasë prej 15.000 eurosh subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, Komisioni ka konsideruar dhe balancën e “Likuiditete në BKT” prej 15.643 eurosh, që i korrespondon balancës së depozitës në BKT, që ka mbetur pas dhënies së huasë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit¹⁷. Lidhur me këtë konsiderim të Komisionit, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji në vendimmarrje të mëparshme të tij, lidhur me detyrimin e subjektit për të provuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje apo dhurimi, ka mbajtur qëndrimin se [...] në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur¹⁸. Në rastin konkret, sipas jurisprudencës së Kolegjit, trupi

¹⁷ Në datën 2.7.2012, para dhënies së huasë, balanca e depozitës ka qenë 30.643,04 euro.

¹⁸ Shih vendimet nr. 15/2019 (JR), nr. 20/2019 (JR) dhe nr. 2/2023 (JR) të Kolegjit.



gjykues vëren se Komisioni duhet të limitohet deri në verifikimin e mundësisë së personave të tjerë të lidhur për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumë e huasë prej 15.000 eurosh, duke mospërfshirë në analizën financiare pasuritë e tjera të tyre, në këtë rast shumë e mbetur në depozitën bankare, dhe duke e thelluar në këtë mënyrë balancën negative të personave të tjerë të lidhur. Konkluzioni për mungesë të burimeve të ligjshme nuk duhet të shtrihet dhe të përfshijë edhe pasuri të cilat nuk kanë lidhje me huanë, pas dhënies së saj në vitin 2012.

62. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson si të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën e Komisionit për personat e tjerë të lidhur L. e M. Sh. nuk duhet të ishte përfshirë dhe shuma prej 15.643 eurosh që vëllai dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të depozituar në BKT, dega Korçë. Por pavarësisht këtij konkluzioni, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit përsëri nuk arrin të provojë tërësisht burimet e ligjshme për dhënien e huasë nga personat e tjerë të lidhur. Referuar analizës së kryer në Komision, duke mos u konsideruar pasuria "Likuiditete në BKT" prej 15.643 eurosh që ka rezultuar balanca e likuiditeteve në BKT pas dhënies së huasë në datën 02.07.2012 e duke lënë të gjithë elementët e tjerë në analizë si Komisioni, rezulton se personat e tjerë të lidhur, vëllai dhe kunata e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2005-2011, rezultojnë me balancë negative prej 5.538 eurosh për dhënien e huasë 15.000 euro.
63. Në vijim të pretendimit të subjektit, referuar kontrollit të analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke mos konsideruar në analizën e personave të tjerë të lidhur pasuritë e tjera të tyre, si trajtuar në paragrafin më sipër¹⁹, trupi gjykues konstaton se në vitin 2005 të ardhurat prej 6.512 eurosh²⁰ janë më të vogla se shpenzimet e jetesës prej 8.900 eurosh sipas EUROSTAT.²¹ Për rrjedhojë, duke mos përfshirë vitin 2005, në analizën e viteve 2006 - 2011, për një total të ardhurash prej 81.970 eurosh²², shpenzime jetese prej 81.999 eurosh²³, kompensime prej 14.879 eurosh²⁴, si dhe duke zbritur dhurimin në vitin 2007 prej 3.000 eurosh dhe huanë në vitin 2012 prej 15.000 eurosh, në përfundim për personat e tjerë të lidhur rezulton një diferencë negative prej 3.150 eurosh. Trupi gjykues vlerëson se kjo diferencë negative e vetme nuk do të përbënte një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, por për shkak të peshës që ajo zë në vlerën totale të shumës së dhënë hua prej 15.000 eurosh, në këtë rast nuk mund të zbatohet parimi i proporcionalitetit dhe të konsiderohet se personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të ligjshme për të justifikuar dhënien e huasë.
64. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka kryer llogaritjen e të ardhurave për personat e tjerë të lidhur, vëllain dhe bashkëshorten e tij, duke filluar nga viti 2005, duke përjashtuar çdo lloj

¹⁹ Ku rezultoi balanca negative prej 5.538 eurosh.

²⁰ Prej 4.532 eurosh, sipas akteve të sjella nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, të ardhurat e tyre dhe 1.980 euro kompensimet, total prej 6.512 eurosh.

²¹ Në shumë 8.900 euro për vitin 2005, ku Komisioni ka përpjesëtuar për 4 persona dhe për llogaritjen për 3 persona sa ka qenë familja e L. Sh. (11.866 euro / 4 veta x 3 veta = 8.900 euro).

²² Nga të ardhurat e llogaritura në analizën financiare në Komision 86.501 euro duke zbritur ato të vitit 2005 prej 4.532 eurosh.

²³ Nga shpenzimet e llogaritura në analizën financiare në Komision 90.899 euro duke zbritur ato të vitit 2005 prej 8.900 eurosh.

²⁴ Nga kompensimet e llogaritura në analizën financiare në Komision 16.859 euro duke zbritur ato të vitit 2005 prej 1.980 eurosh.



kursimi para këtij viti, konstatohet sipas akteve në fashikujt e Komisionit se të ardhurat e tyre në Greqi rezultojnë të jenë 2.730 euro për vitin 2003 dhe 5.552 euro për vitin 2004. Sipas verifikimit të kryer në Kolegj, referuar të dhënave të EUROSTAT²⁵ për Greqinë, në nivelin e *at risk of poverty threshold*, pra, në kufirin e varfërisë²⁶, shpenzimet e jetesës rezultojnë më të larta se të ardhurat e konfirmuara me dokumentacion për personat e tjerë të lidhur²⁷ dhe, në këto kushte, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit nuk do ndikonte në përmirësimin e rezultatit të analizës financiare të personave të tjerë të lidhur.

65. Për sa i përket shumës prej 3.000 eurosh dhënë nga vëllai, subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit sqaron se kjo shumë, që vëllai ka dhënë si ndihmë për shkak të mbajtjes nga ana e subjektit të prindërve, është e ardhur nga tërheqjet që L. Sh. ka bërë nga llogaria e tij në Bankën Kombëtare të Greqisë në vitin 2007 dhe konkretisht në shumat 4.800 euro në datën 05.07.2007 dhe 4.800 euro në datën 03.12.2007. Trupi gjykues e konsideron si të paqartë dhe jo relevant këtë shkak ankimi të subjektit të rivlerësimit, pasi nga vendimi objekt shqyrtimi rezulton se Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në përgjigje të rezultateve hetimore në analizën financiare përfundimtare, e ka përfshirë këtë dhurim të deklaruar nga vetë subjekti në vitin 2007.
66. Në përfundim, për huanë e dhënë për blerjen në vitin 2012 të apartamentit në Tiranë, Kolegji e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të mos përfshirë në analizën financiare të huadhënësve L. Sh. dhe M. Sh., pasuritë e tjera të tyre, por vëren se edhe duke pranuar këtë pretendim të subjektit, përsëri personat e tjerë të lidhur rezultojnë se nuk mbulojnë me burime të ligjshme plotësisht huanë e dhënë në vlerën prej 3.150 eurosh, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" të ligjit nr. 84/2016. Kjo pamjaftueshmëri nuk mund të qëndrojë si shkak i vetëm shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, por u konsiderua nga Kolegji në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

- ***Lidhur me konkluzionin e Komisionit për detyrimet financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes***

67. Komisioni në vendim nuk i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e paraqitura nga subjekti se shuma prej 10.100 eurosh, derdhur në llogarinë e shtetasve L. dhe M. Sh. nga bashkëshortja e tij, nuk përfaqëson shlyerjen e huasë së marrë prej tyre, por janë para të sjella nga vëllai dhe bashkëshortja në Shqipëri, të cilat për lehtësi i ka derdhur bashkëshortja e tij. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion pasi, referuar dokumentit lëshuar nga Banka Kombëtare Greke, të sjellë nga subjekti pas prapësimeve të rezultateve hetimore, e përkthyer dhe noterizuar në datën 14.9.2022 me nr. {***} rep., nga analizimi i llogarisë bankare nr. {***}, të shtetasve L. dhe M. Sh. nuk evidentohen tërheqje që në total të përbëjnë shumën prej 10.100 eurosh. Në fillim të vitit 2013, gjendja e

²⁵ [Database - Income and living conditions - Eurostat \(europa.eu\)](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_4682723/default/table?lang=en)

²⁶ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_4682723/default/table?lang=en; Për një familje me dy të rritur dhe fëmijë poshtë moshës 14 vjeç.

²⁷ Shpenzimet në shumën 10.339 euro për vitin 2003 për një familje me 4 persona , përlllogaritur për 3 persona sa ka qenë familja e L. Sh. do ishin 7.754 euro; shpenzimet në shumën 11.143 euro për vitin 2004 për një familje me 4 persona, përlllogaritur për 3 persona sa ka qenë familja e L. Sh. do ishin 8.357 euro, duke tejkualuar të ardhurat e vërtetuara me dokumente në vitet përkatëse 2003 e 2004.



llogarisë në Bankën Kombëtare Greke ka rezultuar të jetë rritur nga 5.600 euro dhe në fund të vitit 2014 gjendja e llogarisë është rritur me shumën 8.600 euro. Pra, nuk rezulton i provuar nga dokumentacioni bankar i administruar pretendimi i subjektit se këto para janë sjellë nga i vëllai në Shqipëri dhe më pas janë depozituar nga bashkëshortja e subjektit.

68. Në lidhje me mundësinë e subjektit për të shlyer huanë, sipas deklarimeve të tij në deklarata periodike vjetore, Komisioni ka vlerësuar si të drejtë pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga prindërit e subjektit për vitet 2013 dhe 2014. Nga analiza financiare e rikryer nga Komisioni pas përfshirjes të pensioneve, subjekti rezultoi me balancë pozitive, pra, kishte mundësi financiare për të shlyer huanë me burime të ligjshme sipas deklarimeve të subjektit në DPV-të përkatëse.
69. Subjekti i rivlerësimit pretendon se provohet nga autorizimi i lëshuar se katër derdhjet e bëra nga bashkëshortja J. Sh. në llogarinë e L. e M. Sh., ndodhur në BKT, dega Korçë, në shumën e përgjithshme 10.100 euro, nuk kanë lidhje me shlyerjen e huasë prej 15.000 eurosh të marrë te vëllai dhe kunata L. e M. Sh., për blerjen e shtëpisë në Tiranë. Shuma prej 10.100 eurosh janë të ardhurat e vëllait dhe kunatës L. e M. Sh. të fituara në vite nga puna e tyre e kryer në Greqi, ku dhe janë emigrantë, të cilat mbaheshin *cash* prej tyre, mbështetur dhe nga deklarata e lëshuar prej tyre. Duke mos qenë të ardhura familjare të subjektit ato dhe nuk janë deklaruar në deklaratimet vjetore periodike.
70. Nga dokumentacioni në fashikullin e Komisionit, rezulton se subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij se shuma 10.100 euro nuk ka lidhje me shlyerjen e huasë, ka paraqitur dokumentacionin:
- 70.1. Autorizim lëshuar nga shtetasi L. Sh., i cili autorizon J. Sh. që të bëjë derdhje në llogarinë nr. {***} çdolloj shume në euro, me afat 1 vit. Ky autorizim është një dokument i thjeshtë, me shkrim dore, pa datë. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur dhe 4 mandate origjinale depozitimi *cash* të BKT-së, për depozitimet kryer nga J. Sh. në llogarinë e L. e M. Sh., me përshkrimin “me autorizim”.
- 70.2. Deklarata që kanë bërë me vërtetim nënshkrimi para noterit, në datën 13.09.2022, vëllai dhe kunata e subjektit, L. dhe M. Sh., në lidhje me sqarimin e depozitimeve të kryera nga e shtetasja J. Sh. në llogarinë e tyre të shumave në euro që sillnin nga Greqia dhe që i përkasin katër depozitimeve në vitet 2013 - 2014. Në këtë deklaratë huadhënësit sqarojnë se shlyerja e detyrimit prej 15.000 eurosh, që J. Sh. ka marrë prej tyre me dijeni të bashkëshortit, është bërë fizikisht dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare.
71. Ndërsa bashkëlidhur ankimit subjekti ka sjellë deklaratat periodike të viteve 2019 e 2020 për të provuar se ka vazhduar të deklarojë shlyerjen e huasë ndaj L. e M. Sh., sipas deklarimeve periodike nga 2013 deri në vitin 2020, siç shprehet në ankim.
72. Për sa i përket shlyerjes së huasë, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar: “Afati i shlyerjes së detyrimit është 10 (vjet), duke filluar nga data 13.07.2012. Vlera e mbetur 6.000 euro”. Gjithashtu, konstatohet se në deklaratat periodike vjetore



të pasurisë të viteve 2012-2016, në seksionin detyrime, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e huasë, shlyerjen e saj dhe detyrimin e mbetur për çdo vit.

73. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të shlyer huanë me burime të ligjshme, pavarësisht se është shprehur se nuk ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit se depozitat nuk përfaqësojnë shlyerjen e huasë së marrë, por pa i dhënë asnjë pasojë subjektit për këtë paqartësi. Në këto kushte, lidhur me shlyerjen e huasë, subjekti ka rezultuar se ka qenë në kushtet e deklarimit të saktë dhe me burime të ligjshme, sipas parashikimeve të shkronjës "a", pika 5, neni 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, shqyrtimi i shkakut të ankimit të subjektit në lidhje me depozitimet e kryera nga bashkëshortja, duke mbajtur në konsideratë konkluzionin përfundimtar të Komisionit lidhur me shlyerjen e huasë, bëhet vetëm në kuadër të ankimit të paraqitur prej tij ndaj disa konstatimeve të Komisionit, por nuk ka asnjë relevancë në lidhje me vlerësimin përfundimtar të dhënë nga Komisioni për huanë.
74. Në vlerësim të sa më sipër, së pari rezulton se akti i autorizimit, në bazë të të cilit subjekti i rivlerësimit pretendon se janë kryer depozitimet, është një akt që nuk jep asnjë të dhënë për kohën kur është hartuar dhe, për rrjedhojë, edhe për fillimin dhe mbarimin e afatit njëvjeçar të përmendur në të. Nga mandatet bankare të depozitimeve në BKT, dega Korçë, del se janë kryer 4 depozitime në datat 05.08.2013, 13.11.2013, 30.01.2014 dhe 22.05.2014, që i korrespondojnë një periudhe gati njëvjeçare. Në këto mandate është përmendur se veprimet janë kryer nga J. Sh. me autorizim. Nga këto dokumente vërtetohet se bashkëshortja e subjektit ka kryer efektivisht depozitimet në llogarinë e L. dhe M. Sh., por nuk ka asnjë të dhënë që e lidh autorizimin me mandatet/depozitimet e kryera.
75. Për sa i përket deklaratës noteriale lëshuar nga L. e M. Sh., sipas së cilës *eurot që kanë sjellë nga Greqia L. e M. Sh. kanë qenë euro që kishin cash në shtëpinë e tyre në Kozan të Greqisë, nuk janë tërhequr nga Banka Kombëtare e Greqisë ku ata kanë llogarinë dhe depozitimi i tyre në disa raste është bërë nga kunata J. Sh.*, rezulton se kjo deklaratë është dhënë në datën 13.09.2022, paraqitur nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit. Duke konsideruar këtë deklaratë së bashku me të dhënat që rezultojnë nga deklaratat periodike të viteve 2013 - 2020 dhe nga deklarata *vetting*, sipas të cilave subjekti deklaroi se është duke shlyer akoma huanë e marrë, trupi gjykues, në përfundim, vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se shumat e depozituara me autorizim nga bashkëshortja e tij nuk kanë të bëjnë me shlyerjen e huasë.
76. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni në vendim ka konstatuar disa problematika lidhur me punësimin e subjektit të rivlerësimit në ShBA, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për statusin dhe etikën e prokurorëve, si dhe për mosdeklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera gjatë qëndrimit në këtë shtet.
77. Rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të përfituara nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes në ShBA për periudhën 2008 – 2016, në shumën 80.945 USD. Gjatë hetimit Komisioni, pasi ka konstatuar se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit informacion dhe dokumentacion provues për të ardhurat e krijuara në ShBA, duke specifikuar natyrën juridike të punës së kryer prej tij.



kontratat e punëve përkatëse, lidhjen që kanë pasur me punëdhënësit për ditët e qëndrimit në ShBA, dokumentacion provues për pagesat e detyrimeve tatimore, në përputhje me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe dokumentacion provues që subjekti i ka deklaruar këto të ardhura në hyrje të territorit shqiptar, si dhe destinacionin e këtyre shumave të përfituara në vite. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në Komision se mosdeklarimi ndër vite i të ardhurave të fituara në ShBA është bërë pasi të gjithë anëtarët e familjes së tij nga viti 2004 e në vazhdim janë rezidentë në ShBA dhe ekzistenca në këtë vend me të drejta të plota krijonte edhe detyrimin për pagim taksash. Ndërsa për mosdeklarimin e shpenzimeve subjekti ka pretenduar se shpenzimet e tij për udhëtime në ShBA për vete dhe familjarët e tij nuk kanë qenë në pragun e kërkuar për deklarim, në shumën 300.000 lekë. Lidhur me marrëdhënien juridike të punësimit, subjekti ka shpjeguar se ai dhe bashkëshortja kanë punuar si të vetëpunësuar dhe se kanë kryer punë të thjeshta. Komisioni, në përfundim, ka konkluduar se subjekti ka pasur detyrim ligjor të deklaronte shumat e plota të përfituara nga punësimi i tij, bashkëshortes dhe vajzës në ShBA, nga vitit 2008 e në vijim në deklaratat periodike vjetore, dhe se në deklaratën *vetting* ka korrigjuar pasaktësitë në lidhje me deklarimin e këtyre të ardhurave. Komisioni ka arsyetuar se pasaktësitë në deklarimin e të ardhurave, të pa shoqëruara me mungesë burimesh të ligjshme, nuk janë penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

78. Lidhur me punësimin në ShBA, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit edhe në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, pasi ka konstatuar se dypunësimi deri në vitin 2016 nuk lejohej dhe ka qenë në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit²⁸. Subjekti ka prapësuar në Komision se referuar legjislacionit shqiptar në fuqi, pengesa për dypunësim për magjistratët vlen vetëm brenda vendit dhe jo jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe se vetëpunësimi në ShBA është bërë kur ka qenë me leje të zakonshme, dhe se nuk ka sjellë pasoja në punën e tij si prokuror. Komisioni ka analizuar sjelljen e subjektit të rivlerësimit në drejtim të shkeljes së etikës dhe, në përfundim, ka vlerësuar se dypunësimi, jo vetëm që është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit, por është sjellje joprofesionale dhe joetike nga ana e subjektit të rivlerësimit.
79. Për sa më lart, lidhur me punësimin dhe të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit jashtë vendit, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim, edhe pse ka vlerësuar se sjellja e subjektit përbën shkelje të etikës në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, nuk ka mbajtur qëndrim për ndikimin që ka pasur sjellja e subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka konkluduar për t'i dhënë pasojë në vlerësimin tërësor të çështjes së tij lidhur me kriterin e pasurisë, për mosdeklarimin në vite të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera duke pamundësuar kontrollin e burimit të të ardhurave dhe ligjshmërinë e tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues, duke mos anashkaluar rëndësinë që kanë në këtë rast veprimet dhe sjellja e subjektit në besimin e publikut tek integriteti dhe autoriteti i magjistratit dhe duke iu përmbajtur vetëm shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, konkludon se në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë sipas nenit 4, pika 2 e ligjit

²⁸ Në nenin 39 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", parashikohej se prokurorit i ndalohej dypunësimi, me përjashtim të veprimtarive edukative e të mësimdhënies. Ndërsa ligji nr. 96/2016 parashikon se magjistrati ka të drejtë të kryejë veprimtari jashtë funksionit vetëm për veprimtari të tilla si të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to.



nr. 84/2016, situata faktike e paraqitur lidhur me dypunësimin krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.

80. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Edmond Shytko nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme. Për pasojë, bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vendimi nr. 566, datë 28.09.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.09.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi



MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin (JR) nr. 40, datë 27.09.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Shytko, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 566, datë 28.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, por kam mendim kundër/paralel me shumicën e trupit gjykues për sa u përket çështjeve që do të arsyetohen në vijim.

2. *Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 54,5 m², ndodhur në Pogradec, shumica e trupit gjykues, në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore, në paragrafët 50 dhe 51 të vendimit, konkludon: [...] subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë pretendimet e tij lidhur me shkaqet e blerjes dhe dhurimit të apartamentit prej kunatit M. Gj. dhe krijon bindjen se rrethanat faktike çojnë drejt argumentimit të dyshimit se pasuria apartament mund të jetë faktikisht një pasuri e blerë nga vetë subjekti i rivlerësimit. Prandaj, vlerësohet se qëndrimi i Komisionit mbi shkaqet e dhurimit të kësaj pasurie, rezulton i bazuar në situatën faktike. [...] subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, dhuruesit M. Gj., që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2007. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm burimet financiare të ligjshme të dhuruesit për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.*

2.1. Në cilësinë e gjyqtares/anëtares së trupit gjykues, çmoj se verifikimi për mundësinë financiare të dhuruesit, z. M Gj., si detyrim ligjor i parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, duhet të ishte kryer me qëllim identifikimin e faktit nëse kjo pasuri është blerë realisht nga kunati i subjektit apo nga vetë subjekti i rivlerësimit.*

2.2. Nga verifikimi i hetimit administrativ të kryer në Komision, ka rezultuar e analizuar edhe mundësia e subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2007 bazuar në nenin 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016. Kjo analizë është shtrirë dhe për personin tjetër të lidhur me të, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në përfundim, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, dhuruesit M. Gj., të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2007 dhe se vetë subjekti i rivlerësimit nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme financiare të ligjshme për të blerë apartamentin në vitin 2007, në shumën 2.500.000 lekë.

2.3. Referuar nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: *subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur, shumica e trupit gjykues duhet t'i kishte shkuar më tej analizës ligjore lidhur me këtë pasuri, por pa u thelluar, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm burimet financiare të*



ligjshme të dhuruesit për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

2.4. Për mua si gjyqtare, ky konkluzion i shumicës nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin, pasi kunati i subjektit dhe vetë subjekti i rivlerësimit rezultuan me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2007, vlerësuar në raport me faktin se kunati i tij në momentin e blerjes së apartamentit ishte me punë në Tiranë e banonte në qytetin e Mamurrasit dhe nuk kishte asnjë lidhje me qytetin e Pogradecit, rrethana këto që të krijojnë bindjen se ky apartament është pronë e subjektit të rivlerësimit i blerë nga vetë ai. Për rrjedhojë, kurrsesi shumica e trupit gjykues nuk duhet të ishte ndalur vetëm në pamjaftueshmëri, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, por duhet të kishte konkluduar në pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, në aplikim të nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.

3. *Lidhur me burimin e deklaruar "hua pa interes në shumën 15.000 euro, marrë vëllait dhe bashkëshortes së tij", për blerjen e pasurisë apartament, me sipërfaqe 91,88 m², Tiranë, shumica e trupit gjykues, në paragrafin 66 të vendimit, ka arritur në përfundimin: [...] për huanë e dhënë për blerjen në vitin 2012 të apartamentit në Tiranë, Kolegji e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të mos përfshirë në analizën financiare të huadhënësve L. Sh. dhe M. Sh., pasuritë e tjera të tyre, por vëren se edhe duke pranuar këtë pretendim të subjektit, përsëri personat e tjerë të lidhur rezultojnë se nuk mbulojnë me burime të ligjshme plotësisht huanë e dhënë, në vlerën prej 3.150 eurosh, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016. Kjo pamjaftueshmëri nuk mund të qëndrojë si shkak i vetëm shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, por u konsiderua nga Kolegji në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.*

3.1. Në vijimësi të qëndrimit konstant të mbajtur prej meje përgjatë shqyrtimit të çështjeve në Kolegj, pamjaftueshmëria financiare e konstatuar për personin tjetër të lidhur, në cilësinë e dhuruesit apo huadhënësit, nuk kufizohet vetëm në sasinë e munguar të burimeve të ligjshme të shumës së dhuruar apo huazuar, por afekton ligjshmërinë e të gjithë kësaj shume dhe, për pasojë, e përjashton atë nga mesi i burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.

3.2. Me fjalë të tjera në rastin konkret, shumica e trupit gjykues konkludon se huadhënësi nuk justifikon me të ardhura të ligjshme huanë 15.000 euro, për vlerën 3.150 euro, duke i konsideruar kështu të ligjshme diferencën prej 11.850 eurosh.

Çmtoj se shumica e trupit gjykues gabon në logjikën e përdorur, pasi në kuadër të procesit të rivlerësimit, nuk duhet të ishte bazuar thjesht në një rezultat matematikor, por në vlerësim të mirëfilltë ligjor. Sipas analizës së kryer në Komision, dhuruesit nuk kishin mundësi t'i jepnin këtë shumë subjektit për blerje apartamenti në Tiranë dhe, mbi të gjitha, mënyra e kthimit të kësaj huaje nuk është deklaruar saktë nga subjekti në përputhje me dokumentacionin e administruar, analizë e cila të krijoj bindjen se në përfundim, duhet konkluduar në pamjaftueshmëri financiare në vlerën e huasë prej 15.000 eurosh.

4. Në vijim të qëndrimit të mbajtur si gjyqtare e Kolegjit, shpreh mosdakordësinë me konkluzionin e shumicës në paragrafin 78 të vendimit: [...], trupi gjykues, duke mos anashkaluar rëndësinë që kanë në këtë rast veprimet dhe sjellja e subjektit në besimin e publikut tek integriteti dhe autoriteti



i magjistratit dhe duke iu përmbajtur vetëm shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, konkludon se në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, situata faktike e paraqitur lidhur me dypunësimin krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës [...], pasi referimi vetëm shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në gjykimin tim është i gabuar dhe nuk i përgjigjet gjuhës së ligjit të posaçëm të rivlerësimit.

Në këndvështrimin tim, dypunësimi duhet të ishte trajtuar si shkelje e etikës së subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht se Komisioni e ka trajtuar në këtë linjë në vendimin e tij, në përfundim nuk e ka vlerësuar si shkak për shkarkim nga detyra, por është mjaftuar vetëm me arsyetimin se: *[...] Komisioni vlerëson se dypunësimi i subjektit jo vetëm që është në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit, por është sjellje joprofesionale dhe joetike nga ana e subjektit të rivlerësimit [...].* Çmtoj se Kolegji duhet ta kishte saktësuar vendimin e Komisionit, duke e trajtuar dypunësimin në kuadër të etikës si shkak për shkarkim nga detyra, por në asnjë rast shumica e trupit gjykues nuk duhet të kishte përfshirë këtë situatë faktike dypunësimi, në kuadër të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës. Kolegji është organ publik dhe, pavarësisht shkaqeve të ankimit, mbron interesin publik duke i dhënë zgjidhje të drejtë çështjes që trajton, duke mbrojtur njëkohësisht dhe të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

